

Data 07.08.2025

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROCEDURËS: “SHPENZIME PËR MATERIALE ELEKTRIKE ”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Llamba
31521000-4

VLERA E FONDIT LIMIT: 5,247,092 (Pesë milion e dyqind e dyzet e shtatë mijë e nëntëdhjetë
e dy) leke pa Tvsh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe
nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit
publik”, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Gjirokaster** ka hartuar procesverbalin për
argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën
e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

c. *Formulari i ofertës, sipas Shtojcës 1*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM
nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika
5, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe nenit

(Shënim: përcaktoni **nëse është rasti**, aktin konkret ligjor ose nënligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale që lidhet me objektin e prokurimit).

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare. 2022-2023-2024, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Bazuar në vlerën e fondit limit, vlera është nën kufirin e ulët monetar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjin nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2022-2023-2024 të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, pika “c”, të ligjit nr. 10091 datë 5.3.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” i ndryshuar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivit dhe pasivit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjin nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe neni 41, pika “c”, e ligjit nr. 10091 datë 5.3.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” i ndryshuar.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20. % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.4 Operatori ekonomike duhet të deklarojë se merr përsipër dorezimin e mallit brenda afatit të përcaktuar në DST sipas specifikimeve perkatese.

2.5 Operatori ekonomik duhet të deklarojë se merr përsipër të kryej shërbimin e transportit dhe shpërndarjen e mallrave në adresat e Drejtorive perkatese .

2.6 Operatorët Ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesin nga një mostër për secilin mall të kërkuar nga Autoriteti Kontraktor sipas tabelës së mëposhtme.

Nr. Rendor	Emërtimi i Artikujve
41	Ndriçues Klasik 30 W, 3000 K , 3300 Lm CE
42	Ndriçues Led 100 W , 4000 K , 1100 Lm (100000 orë pune) 5 vjet garanci (CE)
6	Drite skenike (Prozhektor ndjekës skenik 2000W me lente rrethore dhe 3ocus të përqendruar për përdorim teatror)
32	Llamba prozhektori 2000W (CE) me kunj
64	Prozhektor skenik slim led 24X18 4N1

- Mostrat do të paraqiten në ditën dhe orën e hapjes së ofertave të percaktuar në dokumentat e tenderit pranë zyrës së Protokoll- Arkiv pranë Bashkisë Gjirokastrë.
- Per paraqitjen e mostrave do të mbahet proces –verbal për të administruar procesin e dorezimit midis Komisionit të Vlerësimit të Ofertave dhe Operator-it/ eve Ekonomik.
- Ky kriter i shërben AK për të gjykuar më mirë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike të produkteve të kërkuara me qëllim që cilësia të jetë në përputhje me kërkeat për rokurim.
- Mostrat do të jenë me etiketë të ngjitur e cila tregon ” emërtimin e artikullit ” numrin rendor sipas preventivit të ngarkuar dhe ofertës së tyre, emrin e ofertuesit dhe vulën e operatorit ekonomik.
- Mostrat e paraqitura do të trajtohen si informacion konfidencial tregëtar dhe do të jenë në kontroll të AK
- **Mosparaqitja e mostrave përbën kusht për skualifikim.**
- **Paraqitja e mostrave pas ores 11:00 pranë zyrës së Protokollit përbën kusht për skualifikim.**
- Mosparaqitja e mostrave sipas specifikimeve teknike përbën kusht për skualifikim.
- Operatori ekonomik fitues do të dorëzojë mallin pas lidhjes se kontratës të njëjta me mostrat e dorëzuara në të kundërt përbën kusht për zgjidhje kontrate.

KUJDES

Operatori ekonomik pjesmarrës duhet të ofertojë sipas vlerave te kodeve buxhetore perkatese në preventiv ne te kundert perben kusht per skualifikim

KUJDES KODET E BUXHETIT JANË SI MË POSHTE VIJON:

V822AAC	49,550
V823AAB	204,040
V644AAB	4,166,610
V912AAB	248,397
V923AAB	413,455
V923AAD	165,040

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

NJËSI E PROKURIMIT

Lorjana Shehu

Bexhet Baxhella

Rigelsa Alikaj